



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për Atashetë e Mbrojtjes.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 dhe 59 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Driton Selmanaj, Zëvendëskryeministër përfaqëson Qeverinë në punimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, nenit 11 të Statutit të Këshillit Konsultativ duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i nominon tre (3) përfaqësues të saj në Këshillin Konsultativ për Komunitete si në vijim:
  - 1.1. Ivan Milojevic;
  - 1.2. Lidon Pajaziti; dhe
  - 1.3. Suhat Ademi.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia procedoj Këshillit Konsultativ për Komunitete i cili vepron nën ombrellën e Presidentit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/24 i datës 14.08.2020 për aprovimin e Koncept Dokumentit për themelimin e Agjencisë për Integrim Evropian.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/34

Datë: 07.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 57 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohen Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dhënien e pajtimit për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës si në vijim:
  - 1.1. Vendimi Nr. 03/101 i datës 30.12.2009;
  - 1.2. Vendimi Nr. 07/11 i datës 20.04.2011;
  - 1.3. Vendimi Nr. 02/66 i datës 14.03.2012;
  - 1.4. Vendimi Nr. 08/91 i datës 12.09.2012;
  - 1.5. Vendimi Nr. 07/129 i datës 08.05.2013;
  - 1.6. Vendimi Nr. 04/16 i datës 04.03.2015;
  - 1.7. Vendimi Nr.13/19 i datës 18.03.2015;
  - 1.8. Vendimi Nr. 08/23 i datës 15.04.2015;
  - 1.9. Vendimi Nr. 09/23 i datës 15.04.2015;
  - 1.10. Vendimi Nr. 07/08 i datës 13.10.2017;
  - 1.11. Vendimi Nr. 14/16 i datës 01.12.2017;
  - 1.12. Vendimi Nr. 09/28 i datës 05.02.2018;
  - 1.13. Vendimi Nr. 07/33 i datës 28.02.2018;
  - 1.14. Vendimi Nr. 08/60 i datës 07.08.2018;
  - 1.15. Vendimi Nr. 20/63 i datës 03.09.2018;
  - 1.16. Vendimi Nr. 08/65 i datës 13.09.2018;
  - 1.17. Vendimi Nr. 19/68 i datës 09.10.2018;
  - 1.18. Vendimi Nr. 08/80 i datës 18.12.2018;
  - 1.19. Vendimi Nr. 18/111 i datës 19.07.2019;
  - 1.20. Vendimi Nr. 05/21 i datës 02.04.2020.
2. Obligohen të gjitha institucionet/organizatat buxhetore që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe t'i ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e përcaktuara me Ligj dhe të mos kryejnë procedura të prokurimit sipas nenit 3 të Ligjit për Prokurim Publik pa vendim të Qeverisë.
3. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HËTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020-2023 i aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, Vendimin e Qeverisë nr. 01/23 datë 13.08.2020 në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani për Zbatimin e Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike Masa 9- Përmirësimi i jetës së komuniteteve jo-shumicë dhe rimëkëmbja e tyre ekonomike.
2. Obligohet Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të zbatoj Planin nga pika 1. të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:


**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqërore të NSH IMN "Kosova"(ish Fabrika e Tjegullave), Prishtinë, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të Komunës së Prishtinës, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave Nr. Protokoll 572 datë 29.11.2011, të bashkëngjitur këtij vendimi në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.



7. Kompensimi i shpronësimit të pronave në vlerën prej 20% të vlerës totale të vlerësimit të pronave është bërë nga Komuna e Prishtinës në emër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit sipas Marrëveshjes të lidhur në mes Komunës së Prishtinës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 27.12.2018 dhe Departamenti i Shpronësimit dhe Qeveria e Republikës e Kosovës nuk kanë asnjë obligim financiar dhe ligjor.
8. Për çdo kontest ligjor, gjyqësor, administrativ dhe teknik që mund të lindë pas miratimit të këtij Vendimi, përgjegjëse për zgjidhjen e tyre do të jenë Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Subjekti Kërkuar (Komuna e Prishtinës) është e obliguar të kryej veprimet administrative dhe teknike për zbatimin e tij në kadastër për regjistrimin e pronave të shpronësuara sipas këtij Vendimi.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/34

Datë: 07.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore për nevoja të realizimit të Projekteve:
  - Ndërtimi i "Lokacionit për Varreza", parcela nr. 522 ZK Zabel i Ulët,
  - Ndërtimi i Lokacionit të "Tregut të Kafshëve", ngastrat kadastrale nr. 893-4, ZK Drenas dhe nr. 325-1 ZK Çikatovë e Re,
  - Zgjerimi i "Zonës Ekonomike në Drenas" parcela nr. 29 ZK Koreticë e Epërme,
  - Ndërtimi i Impiantit për Ujëra të Zeza dhe Industriale të Parkut të Biznesit-Drenas dhe Kanalizimi i fshatit, parcela nr. 132-0 ZK Koreticë e Epërme, parcela nr. 522-0 ZK Zabel i Ulët, të gjitha në Komunën e Drenasit, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, të bashkëngjitur këtij vendimi në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarëve për pagesë të pronës, Komuna e Drenasit do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOCI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet Statusi i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Bifurkacioni nga Ndërmarrja Publike lokale në Ndërmarrje Publike Qendrore.
2. Ndryshimi i Statusit sipas pikës 1. të këtij vendimi ka për qëllim integrimin e komunave Hanit të Elezit dhe Shtërpcës në Kompaninë Rajonale të Ujësjetës "Bifurkacioni".
3. Obligohet Kompania Rajonale të Ujësjetës "Bifurkacioni" në bashkëpunim me institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenin 24A, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020-2023 i aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, në zbatim të Vendimit të Qeverisë nr. 10/33 të datës 28.09.2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve në shumë prej trembëdhjetë milion euro (13,000.000).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Financave me kod 201, nën programi Kontigjencat në Ministrinë e Financave me kod 28900, nga kategoria e shpenzimeve " Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen në Programin për Rimëkëmbje Ekonomike me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë në Bordin e Autoritetit të Aviacionit Civil emëron këta kandidatë:
  - 1.1. Skender Halili, Kryesues;
  - 1.2. Ardian Gaxherri, anëtar;
  - 1.3. Myzejene Selmani, anëtare;
  - 1.4. Jeton Paloka, anëtar;
  - 1.5. Nazlije Krasniqi-Korçaj, anëtare.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, si dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Civile dhe Tregtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Nxitjen e Investimeve ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të zhvilloj negociata me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 14/34  
Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/02 datë 05.06.2020, në zbatim të vendimit nr. 01/23 të datës 13.08.2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi me Nr. 10/33, i datës 28.09.2020, si në vijim:
  - 1.1. Nën paragrafit 1.1 të Vendimit 10/33 i shtohet fjalia duke përfshirë të vetë-punësuarit.
  - 1.2. Pas nën paragrafit 1.1.2. shtohen nën paragrafë të ri 1.1.3, 1.1.4 dhe 1.1.5, të Vendimit Nr. 10/33, si në vijim:
    - 1.1.3 Përjashtimisht nga kërkesat e pikës 1.1 të Vendimit 10/33, të vetë-punësuarit duhet të kenë të deklaruara vetëm deklaratat tremujore për vitin 2019 dhe shuma e subvencionimit do të konsiderohet si për një të punësuar.
    - 1.1.4 Për bizneset e reja të regjistruara në muajin gusht të vitit 2020, referenca për subvencionim do të bazohet në numrin e të punësuarve të deklaruar në deklaratën për muajin gusht 2020, sipas legjislacionit në fuqi.
    - 1.1.5 Për bizneset e reja të regjistruara në periudhën janar-korrik 2020, referenca për subvencionim do të bazohet vetëm në deklaratën e tatimit të mbajtur në burim për muajin korrik 2020, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të gjitha pikat tjera mbeten sipas vendimit bazë Nr. 10/33.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe të gjitha ministrinë përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

Me qëllim të zbatimit të vendimit Nr. 10/33 në frymën e tij të gjithëpërfshirës, si dhe saktësimin të disa detajeve të tij, Komisioni Ndërmintor i themeluar me vendimin Nr. 99/2020 i datës 29.09.2020, ka rekomanduar plotësimin dhe ndryshimin e vendimit, me qëllim që i njëjti të kuptohet drejt dhe të jetë lehtë i zbatueshëm gjatë procesit të ekzekutimit të tij.

Ndryshimet në vendimin bazë janë si në vijim: konstatimi së pjesë e të punësuarave konsiderohen edhe të vetë-punësuarit, për bizneset e reja të regjistruara gjatë vitit 2020 nuk kërkohen deklaratat tjera përveç deklaratës së tatimit të mbajtur në burim për muajt përkatës (korrik, përkatësisht gusht), si dhe saktëson së për bizneset e reja të regjistruara gjatë muajit gusht, referenca për subvencionim do të bazohet në numrin e të punësuarave të deklaruara në deklaratën për muajin gusht 2020, sipas legjislacionit në fuqi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/34

Datë: 07.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, si dhe pas shqyrtimit të Konceptit për Hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030 në Komisionin për Planifikim Strategjik, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 tetor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030 (në vijim SKZH 2030).
2. SKZH do të jetë dokumenti kryesor i planifikimit afatgjatë për të zbatuar vizionin e Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor.
3. SKZH 2030 ngërthen në vete edhe qëllimin e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, dhe ndërlidhjen me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm nëpërmjet përcaktimit të prioriteteve zhvillimore, objektivave strategjike dhe rezultateve që pritet të arrihen.
4. SKZH 2030, ndër të tjera, do të adresojë sfidat dhe ndikimin e shkaktuar nga pandemia COVID 19 dhe planifikimin e rimëkëmbjes ekonomike.
5. SKZH 2030 do të jetë bazamenti për vendosjen e Kornizës Kombëtare për Menaxhim Strategjik, që duhet të sigurojë thjeshtëzimin, zvogëlimin dhe optimizimin e numrit të madh të strategjive aktuale, duke definuar një strukturë të pastër të sistemit të planifikimit strategjik, hierarkinë dhe tipologjinë e dokumenteve strategjike, definimin e sektorëve, si dhe do të përmirësoj ndërlidhjen e dokumenteve të planifikimit strategjik dhe proceseve buxhetore përmes kaskadimit të objektivave në aktivitete, të cilat në dokumente të ndryshme do të përdoren me formulime dhe kode fikse.
6. Hartimi i SKZH 2030 do të bazohet në Konceptin e SKZH 2030 (si shtojcë e këtij Vendimi) ku janë të përshkruara detajet e procesit, përmbajtjes, planifikimit dhe hartimit nëpërmjet Kalendarit të punës.
7. Procesi i hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim drejtohet/udhëhiqet nga Kryeministri nëpërmjet Komisionit për Planifikim Strategjik (në vijim KPS) dhe Ekipit për përgatitjen e SKZH (në vijim Ekipi), që përbëhet nga Grupi i Përgjithshëm (në vijim GP) dhe Grupet tematike (në vijim GPT).

8. Komisioni për Planifikim Strategjik do të përcaktojë prioritetet dhe objektivat kombëtare të zhvillimit strategjik, si dhe do të shqyrtojë dhe përcaktojë përfundimisht strukturën dhe draftin final të SKZH-së, para miratimit të saj në Qeveri.
9. Kryeministri do të ftojë Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (në vijim KKEI) për të shqyrtuar vizionin, objektivat dhe treguesit e SKZH-së.
10. Përgjegjësitë e Ekipit për përgatitjen e SKZH janë si në vijim:

10.1. Përgjegjësitë e Grupit të Përgjithshëm janë:

- 10.1.1. Shqyrtimi i Kalendarit të punës të procesit të hartimit të SKZH;
- 10.1.2. Shqyrtimi i strukturës përfundimtare të SKZH-së, para se të kalojë për shqyrtim në KPS;
- 10.1.3. Shqyrtimi i objektivave specifike, treguesve të SKZH-së;
- 10.1.4. Shqyrtimi i prioriteteve afatgjata dhe afatmesme për zhvillim kombëtar, para se të kalojnë në KPS dhe shqyrtimi dhe vlerësimi i koherencës ndërmjet SKZH dhe strategjinë përkatëse për fondet e BE-së (IPA) dhe mbështetjen e donatorëve;
- 10.1.5. Shqyrtimi i prioriteteve horizontale dhe shqyrtimi i krijimit të agjendave horizontale;
- 10.1.6. Shqyrtimi final i SKZH-së në tërësi dhe dërgimi i saj për shqyrtim në KPS;
- 10.1.7. Komentimi, rekomandimi dhe propozimi i objektivave dhe prioriteteve për GPT dhe KPS;
- 10.1.8. Propozimi i aspekteve të caktuara për trajtim në GPT, sipas temave përkatëse;
- 10.1.9. Shqyrtimi, vlerësimi dhe komentimi i çështjeve që kërkohen nga KPS;

10.2. Grupet Punuese Tematike koordinohen nga ZPS dhe kanë këto përgjegjësi:

- 10.2.1. Analizimi, shqyrtimi, propozimi dhe hartimi i analizave të mbështetura në sektorë në kuadër të secilës temë;
- 10.2.2. Identifikimi i sfidave dhe problemeve për sektorë dhe propozimi i objektivave strategjike për adresimin e tyre në kuadër të sektorit, të cilat i zbatojnë objektivat strategjike kombëtare;
- 10.2.3. Analizimi, shqyrtimi, propozimi dhe hartimi i objektivave dhe treguesve në kuadër të temës përkatëse;
- 10.2.4. Shqyrtimi, analizimi dhe adresimi i komenteve, rekomandimeve dhe propozimeve të GP dhe KPS;
- 10.2.5. Analizimi dhe shqyrtimi i çështjeve tjera që vijnë nga GP.

11. Anëtarët e Grupit të Përgjithshëm janë:

- 11.1. Kryesuesi i Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (në vijim GDPS), Kryesues;
- 11.2. Këshilltari politik i përcaktuar nga Kryeministri;
- 11.3. Anëtarët e përhershëm të GDPS;
- 11.4. Koordinatorët e Grupeve Punuese Tematike;
- 11.5. Kryesuesi, sipas nevojës, mund të ftojë si anëtar edhe përfaqësues tjerë të ZKM-së dhe Ministrive.

## 12. Anëtarët e Grupeve Punuese Tematike janë:

### 12.1. Tema 1: Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë:

- 12.1.1. Përfaqësuesi i Zyrës për Planifikim Strategjik, (ZPS/ZKM), Koordinator i GPT;
- 12.1.2. Dy përfaqësues nga MD; dy përfaqësues nga MPB; një përfaqësues nga MPJD; një përfaqësues nga MTI; një përfaqësues nga MPL; një përfaqësues nga MM; një përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit; një përfaqësues i Agjencisë për Barazi Gjinore; një përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës; një përfaqësues nga KGJK; një përfaqësues nga KPK; një përfaqësues nga ZAP; një përfaqësues nga Avokati i Popullit; një përfaqësues nga KRPP; një përfaqësues nga OSHP; një përfaqësues nga AKI; një përfaqësues nga Policia e Kosovës; një përfaqësues nga KSK; një përfaqësues nga Dogana; një përfaqësues nga ATK; një përfaqësues nga ZL e ZKM; një përfaqësues nga ZQM e ZKM; një përfaqësues nga ish strukturat e MIE (tash ZKM); një përfaqësues nga MF.

### 12.2. Tema 2: Rritja e qëndrueshme ekonomike:

- 12.2.1. Përfaqësuesi i Zyrës për Planifikim Strategjik, (ZPS/ZKM), Koordinator i GPT.
- 12.2.2. Katër përfaqësues nga MTI; katër përfaqësues nga MEA; pesë përfaqësues MPBZHR; një përfaqësues nga MPMS; katër përfaqësues nga MI; një përfaqësues nga MPJD; një përfaqësues nga MZHR; një përfaqësues nga MKK; një përfaqësues nga Dogana; një përfaqësues nga AKK; një përfaqësues nga ATK; dy përfaqësues nga KIESA; një përfaqësues nga ARPK; dy përfaqësues nga ASK; një përfaqësues nga SKQ e ZKM; një përfaqësues nga ish strukturat e MIE (tash ZKM); një përfaqësues nga MF.

### 12.3. Tema 3: Kapitali njerëzor dhe kohezioni social:

- 12.3.1. Përfaqësuesi i Zyrës për Planifikim Strategjik, (ZPS/ZKM), Koordinator i GPT;
- 12.3.2. Katër përfaqësues nga MASH; tre përfaqësues nga MPMS; një përfaqësues nga APRK; dy përfaqësues nga MSH; një përfaqësues nga MKRS; një përfaqësues nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore; një përfaqësues nga MEA; një përfaqësues nga MKK; një përfaqësues nga MTI; një përfaqësues nga MAPL; një përfaqësues nga MPJD; një përfaqësues nga MI; një përfaqësues nga MPB; nga një përfaqësues prej Universiteteve publike dhe private; një përfaqësues i Agjencisë për Barazi Gjinore; një përfaqësues i Zyrës për Qeverisje të Mirë; një përfaqësues i Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve; një përfaqësues i Agjencisë së Kosovës për Akreditim; një përfaqësues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve; një përfaqësues i Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Kosovës; një përfaqësues i Institutit Pedagogjik të Kosovës; një përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës; përfaqësues i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore; një përfaqësues nga IKSHP; një përfaqësues i Agjencisë së Statistikave të Kosovës; një përfaqësues nga ish strukturat e MIE (tash ZKM); një përfaqësues nga MF.

12.4. Tema 4: Mjedis i pastër dhe burime të qëndrueshme:

12.4.1. Përfaqësuesi i Zyrës për Planifikim Strategjik, (ZPS/ZKM), Koordinator i GPT;

12.4.2. Pesë përfaqësues nga MEA; një përfaqësues nga MI; një përfaqësues nga MBPZHR; një përfaqësues nga MZHR; një përfaqësues nga AMMK; një përfaqësues nga IPH; një përfaqësues nga IMN; një përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës; një përfaqësues nga ARPL; një përfaqësues nga ARRU; një përfaqësues nga KNU; një përfaqësues nga IKSHP; një përfaqësues nga MF; një përfaqësues nga ish strukturat e MIE (tash ZKM).

12.5 Koordinatorët e GPT-ve, sipas nevojës, do të ftojnë në cilësi të anëtarit apo vëzhguesit përfaqësues tjerë nga institucionet publike, partnerët zhvillimorë, sektori privat, shoqëria civile, partnerët social, institucionet akademike, institucionet e huaja që veprojnë në Kosovë, ekspertë të huaj dhe të brendshëm.

12.6. Sipas nevojës, koordinatori i GPT-ve mund të organizojnë punën me anë të nëngrupeve tematike.

13. Zyra për Planifikim Strategjik do të shërbejë si Koordinator i punës së Ekipit përgjatë gjithë procesit të hartimit të SKZH 2030.

13.1. Përgjegjësitë e Zyrës për Planifikim Strategjik, janë:

13.1.1. Planifikimi i Kalendarit të punës për tërë procesin e hartimit të SKZH, dhe dërgimin e të njëjtit për shqyrtim në GP dhe për miratim në KPS;

13.1.2. Planifikimi dhe organizimi i takimeve të KPS-së dhe GP-së, duke përfshirë përgatitjen e materialeve për diskutim dhe përmbledhjen e diskutimeve në KPS dhe GP;

13.1.3. Kryesimin e GPT-ve dhe përgatitjen e udhëzimeve të punës për to;

13.1.4. Vlerësimin e analizave, statistikave dhe problemeve të identifikuar që dalin nga puna e GPT-ve, dhe duke u bazuar në këto, ofrimi i analizës së detajuar të situatës në nivel qendror;

13.1.5. Adresimin e komenteve, vërejtjeve dhe rekomandimeve të GP, KPS dhe palëve të përfshira në hartimin dhe konsultimet publike, në draftin e SKZH;

13.1.6. Organizimin e tryezave publike për diskutimin e objektivave dhe drafteve të SKZH-së;

13.1.7. Raportimi i rregullt i punës të GPT-ve në GP, me anë të raporteve dhe përmbledhjeve;

13.1.8. Mbështetja teknike dhe administrative, sipas nevojës, për Ekipin në tërësi;

13.1.9. Të gjitha shërbimet tjera mbi hartimin e Strategjisë, sipas mandatit të saj.

14. Njësitë brenda Zyrës së Kryeministrit, ministrive dhe institucionet tjera publike, i ofrojnë mbështetje Ekipit, sipas përgjegjësiqe që kanë.

15. Zyra e Kryeministrit merr përsipër krijimin e kushteve të nevojshme për mbarëvajtjen e punës së Ekipit.

16. Obligohen të gjitha institucionet dhe organet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e këtij Vendimi.

17. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive
- Të gjithë anëtarëve të Ekipit
- Arkivit të Qeverisë